



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:300389

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05925385

**P.nr.593/23**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K. B. nga fsh. R. i M. K. Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.846/23F të dt.19.12.2023, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor, jopublik, të mbajtur me datën 10.07.2024, në prani të prokurorit të shtetit Menduhi Kastrati, të pandehurit dhe të dëmtuares E. A. nga fsh. R. i M. K.L., të cilen sipas autorizimit e përfaqëson av. Fatime Mustafa nga Lipjani, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit:

**K.B.**, i lindur me dt....., me vendbanim në fsh. R. i M. në L., ku edhe tani jeton, nga i ati G., nënës E., mbiemri i vajzërisë së nënës B., punëtor, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. letërnjoftimi ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

#### **Sepse:**

Me dt.12.12.2023, rreth orës 19:45<sup>h</sup> në shtëpi e tyre të përbashkët në fshatin R. i M. në L., i pandehuri K. B., me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarës – bashkëshortes se tij E. A., pasi që i pandehuri ka qenë në punë në M. të Z. dhe pa i treguar bashkëshortes së tij është kthyer në shtëpi dhe ka hyrë në shtëpi, ka shkuar në dhomën e fjetjes, aty ka qenë e dëmtuara duke shikuar diçka në telefon, i pandehuri ja ka marr telefonin dhe kur e ka hapur ka parë se në rrjetin social “SnapChat” e dëmtuara ka komunikuar me një person bisede intime dashurije, kur i pandehuri e ka parë këto komunikime, është nervozuar dhe e ka sulmuar te dëmtuarën duke e kapur për fyti, e duke e dërguar me forcë deri në automjet dhe e ka dërguar të dëmtuarën deri në polici duke e kapur për fyti, pa i shkakuar lëndime trupore,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Me dënim gjobë në shumë prej 200 euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 muajve të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) vit nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet.

**E dëmtuara:** E. A. nga fsh. R. i M. K.L., udhëzohen që kërkesën pasuroro juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile.

**DETYROHET** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumë prej 20-€, si dhe shumë nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.846/23F të dt.19.12.2023, e ka akuzuar të akuzuarit K. B. nga fsh. R. i M. K. L., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili e ka bërë në këtë fazë të procedurës ku i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës të ngritur ndaj të akuzuarit ku nga deklarimi i të akuzuarit është vëretuar gjendja faktike si në aktakuzë andaj i ka propozuar gjykatës që pasi ti vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe ato rënduse e veçanërisht pranimin e fajësisë si dhe deklarimin e të dëmtuares e cila nuk ju ka bashkangjitur ndjekjes penale ti shqipton një dënim në bazë të ligjit.

Mbrojtësja e të dëmtuares në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, e dëmtuara tërhiqet nga ndjekja penale dhe nga kërkesa pasurore juridike, ajo vetëm kërkonë që në të ardhmen mos ta shqetësoj, ai ta vazhdonë jetën e vetë, ndërsa e dëmtuara ta vazhdojë vetën e saj ku është e martuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe njëherit ka shtuar se e dëmtuara nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, nuk kërkonë që i akuzuari të dënohet.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se me të dëmtuaren ka tre fëmijë për të cilën tani kujdeset për ta dhe se kjo gjendje ka ardhur me fajin e të dëmtuares e cila ka mbajtur komunikime me një person tjetër dhe pasi ka hasur në telefon nga xhelozia e çdo njeri e ka dërguar deri në automjet dhe e ka dërguar në polici në mënyrë që e ënjëjta të vazhdojë ose me të ose me një tjetër kënd dhe këto veprime i ka bërë pa vullnetin e tij por në shenjë mllëfi. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk do ta pengonë në të ardhem të dëmtuaren ajo e ka zgjedhur rrugën e vetë unë timen, fëmijët kur ti kërkonë me i pa do t'ia mundësoj, e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë nga se kjo situat ka ardhur jashtë vullnetit të tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkëlqje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet.

#### *Matja dhe caktimi i dënimit*

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se

i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishum i shoqërisë, është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, tërheqja nga ndjekja penale e palës së dëmtuar, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

*Vendimi për shpenzimet e procedurës*

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesa pasurore-juridike*

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, dhe gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që në këtë procedurë nuk është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**

**P.nr.593/23 dt.10.07.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale  
Gentiana Dakaj**

**GJYQTARI  
Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:300389  
Datë: 11.07.2024  
Numri i dokumentit: 05925385